

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë sot më datë 04. 02. 1999 për lidhjen e kësaj kontrate shitje kuotash u paraqitën personalisht:

SHITËSI: Vasil KAPURANI, i biri i Leonidhës, ortak i vetëm dhe administrator i Shoqërisë "Vasili" Sh.p.k..

BLERËSI: Dhimitraq Argjiri, i biri i Pandit.

Palët kërkuar reaktimin e kësaj Kontrate Shitjeje Kuotash si më poshtë:

Shitësi Vasil Kapurani, ortak i vetëm dhe administrator i Shoqërisë "Vasili" Sh.p.k, me qendër në Korçë, regjistruar si person juridik nr. 20130/1 5964 dt. 03. 12. 1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë administron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Me vullnetin e tij të lirë e të plotë shitësi Vasil Kapurani bie dakord që nga kuotat e tij të shesë 5% të tyre blerësit Dhimitraq Argjiri me vlerën prej 1.480.369 kelë. Me këtë shitje është dakord edhe blerësi i cili nuk ka asnjë vërejtje. Vë çastin e shitjes së kuotave shitësi zhvishet nga 5% e kuotave me vlerën 1.480.369 dhe zotërues i tyre bëhet blerësi Dhimitraq Argjiri.

Me shitjen e kuotave kapitali i Shoqërisë përbëhet si më poshtë:

1. 95% e kapitalit prej Vasil Kapuranit,
2. 5% e kapitalit prej Dhimitraq Argjirit.

Kontrata u redaktua në tre kopje të barasvlefshme, u lexohet palëve dhe pasi gjendet e pranueshme prej tyre firmoset më vullnetin e tyre të lirë e të plotë.

SHITËSI

Vasil KAPURANI

Vasil Kapurani
[Signature]

BLERËSI

Dhimitraq ARGJIRI

Dhimitraq Argjiri
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 78 Rep.

Nr. 8 Rep.

VËRTETIM

Sot më datë 04. 02. 1999 u paraqitën personalisht ortaku i vetëm dhe administrator i Shoqërisë "Vasili" Sh.p.k. zoti Vasil Kaporani me banim në lagjen 9 Korçë dhe Dhimitraq Argjiri, me banim në lagjen 9 Korçë madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të njohur prej meje, të cilët deklarojnë se sa më sipër është një kontratë shitje kuotash e hartuar me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e nënshkruajnë rregullisht para meje. Unë Notëria pasi bindem për vullnetin e tyre të lirë e të plotë e legalizoj atë.



NOTERË

